

SI TË SILLEM ME FËMIJËN PARA SE TA SJELL NË ÇERDHE?

⇒ Flisni me fëmijën! Edhe pse mund të jeni nervozë apo të shqetësuar për nisjen e çerdhes, përpiquni të jeni gjithmonë pozitivë kur i flisni fëmijës për të.



⇒ Flitini fëmijës për gjërat e reja që do të bëjë atje. Shpjegojani që edhe ju keni qenë i/e vogël në çerdhe dhe jeni kënaqur.

⇒ Shpjegojini që ai nuk do të jetë vetëm dhe se do ketë persona që do të kujdesen vazhdimisht për të.

⇒ Përmendni emrat e edukatoreve të grupit ku ndodhet fëmija juaj. Mos i flisni negativisht për edukatorët.

⇒ Bëni kujdes me emocionet tuaja! Fëmija mund ta ndjejë fare qartë edhe “pa fjalë”, ankthin që ju përjetoni. Në qoftë se ju nuk ndiheni të sigurt për çerdhen ku e çoni, kini parasysh se edhe fëmija do të ketë të njëjtin reagim.

⇒ Nëse fëmija qan me dënësë dhe nuk do t’ju lërë që të ikni, kërkoni këshilla nga edukatorët, psikologu, punonjësi social. Lini një numër telefoni për çdo rast.

⇒ Pasi i keni thënë “Mirupafshim” fëmijës suaj, mos u shqetësoni më. Përpiquni që përshëndetja e ikjes të jetë e shkurtër.

ÇFARË TË BËJ DITËT E PARA?

Merrni kohë! Fëmija nuk është i përgatitur për ndarjen, ndaj ju duhet të punoni para se ta sillni në çerdhe, për ta përgatitur.

Lëreni pak kohë ditën e parë (15-30 minuta) dhe shtojeni kohën ditën tjetër e kështu me radhë duke ndjekur ecurinë e tij/saj.

I thoni fëmijës suaj se kur do të ktheheni, pa e gënjer, p.sh. “Pasi të kesh mbaruar lojën, mami ose babi do të vijnë të të marrin”.

Nëse fëmija qan me dënësë dhe nuk do t’ju lërë që të ikni, kërkoni këshilla nga edukatorët dhe psikologja/punonjësja sociale.

Pasi i keni thënë “Mirupafshim”, mos e zgjasni kokën te xhami. Vetëm pasi prindërit largohen me të vërtetë, fëmija është gati të pranojë dhe të fillojë një eksperiencë të re.

SI TË SILLEMI ME FËMIJËN KUR E MARRIM NGA ÇERDHA?

Kërkoni informacion nga edukatorja për ecurinë e fëmijës dhe aktivitetet që ka bërë. Përdoreni këtë informacion për të folur me fëmijën me zë përkëdhelës, të ngrohtë dhe qetësues, në mënyrë që ai të fitojë siguri nga ju. Përshëndeteni edukatoren duke i thënë fëmijës që nesër do të vini përsëri.

Adresa: Rruga e “Barrikadave”, Tiranë

Tel: +355 422 22991

E-mail: femijet@tirana.al

Uebfaqja: <http://femijetetiranes.al/>

Facebook: Fëmijët e Tiranës



BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
ÇERDHEVE DHE KOPSHTEVE

PËRSHTATJA E FËMIJËVE NË ÇERDHE



Broshurë për prindërit

ÇFARË ËSHTË PËRSHTATJA?

Përshtatja e fëmijës në çerdhe është një proces kalimtar, i konsideruar si një ndër më të rëndësishmit për zhvillimin e fëmijës.

Kjo fazë ka të bëjë me kalimin nga një mjedis i njohur familjar në një mjedis të panjohur, me rregulla, rutina dhe role të reja.

Mënyra se si ky proces do të përjetohej nga fëmija do të përcaktojë edhe qëndrimet dhe përshtatjen e tij në vazhdimësi në çerdhe dhe në institucione të tjera.

DISA NGA FAKTORËT QË NDIKOJNË NË PËRSHTATJE

Karakteristikat e fëmijës

Fëmija juaj mund ta përjetojë me kënaqësi ardhjen në çerdhe, pasi po shkon në një mjedis të ri. Mirëpo, ai/ajo mund të përjetojë edhe ankth, pasi do t'i duhet të largohet nga ju dhe mjedisi familjar për të shkuar në një vend të panjohur për të.

Ndjenjat që mund të përjetojë çdo fëmijë janë të ndryshme: ankthi i shkëputjes nga prindi, nevoja për t'u afruar me të rriturit e tjerë, dëshira për t'u afruar me fëmijët, të pëlqyerit e objekteve të ndryshme, frika për përplasje të mundshme mes tij dhe fëmijëve të tjerë, etj.



Qëndrimi i prindërve dhe familjarëve

Ankthi i fëmijës për t'u ndarë lidhet ngushtë me ankthin që përjeton prindi. Nëse ata perceptojnë sadopak ankth te ju, do të përjetojnë më shumë pasiguri dhe frikë, çka do ta bëjë të vështirë përshtatjen. Procesi i përshtatjes nuk mund të ndodhë nëse prindërit dhe kujdestarët nuk janë ende gati për t'u shkëputur nga fëmija dhe për të pranuar sigurinë e institucionit.

Edukatorët dhe stafi i çerdes

Edukatorët kanë pritshmëritë e tyre rreth fëmijëve të rinj dhe përpiqen të krijojnë një marrëdhënie besimi me kujdestarët primarë të fëmijëve. Ato e lehtësojnë procesin e përshtatjes përmes bisedave, lojërave dhe aktiviteteve të tjera dhe ju mbajnë të informuar për ecurinë e fëmijës suaj gjatë ditës.



RREGULLAT DHE MASAT NDAJ COVID-19

Njihuni me institucionin dhe stafin, rregulloren dhe masat anti-COVID. Me rëndësi këtë periudhë është njohja dhe zbatimi i masave për mbrojtjen nga virusi: sjellja dhe marrja e fëmijës në orar te dera e jashtme e çerdes, matja e temperaturës nga edukatorja, firmosja dhe dorëzimi te edukatorja e grupit, lënia e numrit të telefonit edukatores dhe qëndrimi në gatishmëri për ta marrë fëmijën. Gjatë qëndrimit në çerdhe, stafi kryen termometrimin disa herë në ditë, të cilin e dokumenton; dezinfektimin e mjediseve dhe larjen e shpeshtë të duarve fëmijëve.

SI REALIZOHET PËRSHTATJA NË ÇERDHE?

Përshtatja është graduale dhe ndikohet nga prania e familjarëve. Shoqërimi në çerdhe, derisa fëmija të mësohet me mjedisin e ri, mund të bëhet nga nëna, babai ose nga një tjetër familjar. Përshtatja mund të zgjasë **disa javë**.

Ushqyerja dhe gjumi

Pranimi i ushqimit në çerdhe është një fazë e rëndësishme që nënkupton edhe përfundimin e fazës së përshtatjes. Është normale që fëmija të refuzojë të konsumojë ushqimin, për këtë arsye nuk duhet të insistoni që ai të ushqehet që në ditët e para. Jepini kohë fëmijës që të ulet në tavolinë dhe më pas të provojë ushqimet në çerdhe. Ju mund ta lehtësoni pranimin e ushqimit nga fëmija juaj duke marrë një menu të ushqimit në çerdhe, duke përgatitur disa ushqime të ngjashme, etj. Gjithashtu, ju duhet të informoni stafin nëse fëmija është në gjë, si ushqehet në shtëpi, nëse ka vështirësi me ushqyerjen etj.

Shkëmbimi i informacionit

Kërkoni informacion të vazhdueshëm nga edukatorët rreth mënyrës se si fëmija juaj e kaloi ditën dhe çfarë lojërash dhe aktiviteteve zhvilloi në mënyrë që ju t'i zhvillonin ato edhe në shtëpi.